



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ N. 119 /2011

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës 03/L-040 neni 40, Udhëzimin Administrativ Nr.2011/03 për organizimin dhe funksionalizimin e qendrave të shërbimeve të qytetarëve në Komuna, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 32.2. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më datë: 26.09.2011 mori:

## VENDIM

PËR

NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË ZYRËS SË PRITJES

I

Kuvendi i Komunës miratoi propozim vendimin me numër 02Nr.421 të datës 09.09.2011 për ndryshimin e emërtimit të zyrës së pritjes në Qendër për shërbimin e qytetarëve.

II

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të Komunës, zyra e lartpërmendur do të kryej shërbimet duke përfshirë komunikimin e drejtpërdrejtë me qytetarët dhe bizneset, dhënien e ndihmës profesionale përkatëse për paraqitjen e kërkesave dhe parashtresave nga qytetarët si dhe mënyrën e pranimit dhe trajtimit të tyre

III

Qendra e shërbimit të qytetarëve nëpër komuna do të kryej një vargë detyrash të cilat janë të përcaktuara në udhëzimin e lartcekur dhe me këtë udhëzim shfuqizohet udhëzimi i mëparshëm Nr.2008/5 për zyrat pritëse

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit

V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Administratës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit  
Data: 26.09.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
Menduh Vlasi

